

# FOL

## RAPORTI MBI MONITORIMIN E PUBLIKIMIT TË VENDIMEVE GJYQËSORE



JANAR – DHJETOR 2023





**RAPORTI MBI  
MONITORIMIN  
E PUBLIKIMIT  
TË VENDIMEVE  
GJYQËSORE**

**JANAR – DHJETOR 2023**

Titulli: **Raporti mbi monitorimin e publikimit të vendimeve gjyqësore (janar – dhjetor 2023)**

Autorë: **Lëvizja FOL**

Viti i botimit: **2024**

Publikuar nga: **Lëvizja FOL**

Andrea Gropa nr.35  
Prishtina 10000, Republika e Kosovës  
info@levizjafol.org  
+386 (0)49 131 542

Të drejtat e autorit © 2024. Lëvizja FOL. Të gjitha të drejtat e rezervuara. Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet në ndonjë sistem të ruajtjes së të dhënave apo të transmetohet, në asnjë formë apo mënyrë elektronike, mekanike, fotokopjuese, incizuese apo tjetër, pa pëlqimin paraprak me shkrim nga ana e botuesit.

Qëndrimet e shprehura në këtë punim jo domosdoshmërisht paraqesin ato të Byrosë së Narkotikëve Ndërkombëtar dhe Çështjeve të Zbatimit të Ligjit (INL).

# Përmbajtja

<b>1. Përmbledhja ekzekutive.....</b>	<b>06</b>
<b>2. Metodologjia .....</b>	<b>12</b>
<b>3. Baza ligjore e publikimit të vendimeve gjyqësore .....</b>	<b>14</b>
Gjykata Supreme .....	16
Gjykata e Apelit .....	21
Gjykata Komerciale.....	25
Gjykata Themelore e Prishtinës .....	29
Gjykata Themelore e Mitrovicës.....	35
Gjykata Themelore e Pejës .....	41
Gjykata Themelore e Prizrenit.....	47
Gjykata Themelore e Ferizajt .....	53
Gjykata Themelore e Gjilanit.....	59
Gjykata Themelore e Gjakovës .....	65
<b>Rekomandime .....</b>	<b>71</b>
<b>Burimet: .....</b>	<b>72</b>

# 1. Përmbledhja ekzekutive

Raporti mbi monitorimin e publikimit të vendimeve gjyqësore (janar-dhjetor 2023) përmban të dhëna që rrjedhin nga monitorimi sistematik i publikimit të aktgjykimeve në ueb-faqen zyrtare të Këshillit Gjyqësor të Kosovës gjatë kësaj periudhe një vjeçare. Gjetjet kryesore që rrjedhin nga monitorimi i vendimeve janë renditur në tekstin e mëposhtëm:

- Gjatë periudhës janar-dhjetor 2023 në ueb-faqen zyrtare të Këshillit Gjyqësor të Kosovës janë publikuar gjithsej 40,424 vendime. Ky numër i vendimeve të publikuara është marrë nga monitorimi sistematik i ueb-faqes së KGJK-së për çdo muaj gjatë periudhës janar-dhjetor 2023. Mirëpo pas rishikimit të ueb-faqes në prill të vitit 2024, është vërejtur se është fshirë një numër i aktgjykimeve të dhunës në familje të publikuara në vitin 2023, dhe numri total i publikimit të aktgjykimeve për vitin 2023 tashmë figuron 40,392 aktgjykime, pra 32 aktgjykime më pak. Mirëpo krahas kësaj, ne i jemi referuar të dhënave të nxjerra nga monitorimi jonë i drejtpërdrejtë.
- Ky nivel i publikimit dëshmon rritje të publikimit prej 17 % në krahasim me vitin 2022, ku në ueb-faqen e KGJK-së ishin publikuar 34,694 vendime.
- Gjatë kësaj periudhe janë zgjidhur gjithsej 116,629 lëndë (me përjashtim të lëndëve që nuk do të duhej të publikoheshin)<sup>1</sup>, që nënkupton se janë publikuar rreth 35 % e lëndëve të zgjidhura<sup>2</sup>, përkatësisht 1% më pak se në vitin 2022, kur ishin publikuar 36% e lëndëve të zgjidhura.
- Gjykatat me më së shumti vendime të publikuara në proporcion me lëndët e zgjidhura gjatë periudhës përkatëse janë:
  - **Gjykata Komerciale** – Dhoma e Shkallës së Parë ka zgjidhur 4,017 lëndë, ndërsa ka publikuar 2,755 vendime (69 % të lëndëve); Dhoma e Shkallës së Dytë ka zgjidhur 2,222 lëndë, ndërsa ka publikuar 1,710 lëndë (77% të lëndëve);
  - **Gjykata Supreme** (pa përfshirë Dhomën e Posaçme), e cila gjatë këtij viti ka zgjidhur 1,848 lëndë, ndërsa ka publikuar 1,135 vendime (61 % të lëndëve);

1 Në raportin vjetor statistikor të KGJK-së, janë kategorizuar vetëm lëndët për të mitur dhe kundërvajtjet, lëndë të cilat sipas KPPK-së dhe Rregullores së KGJK-së, nuk do të duhej të publikoheshin. Ndërsa kategoritë e tjera të lëndëve që nuk do të duhej të publikoheshin nuk janë veçuar në tabelat e KGJK-së dhe janë së bashku me lëndët tjera. Prandaj FOL nuk kishte mundësi t'i zbrishte lëndët tjera nga numri total i lëndëve të zgjidhura, përveç lëndëve për të mitur dhe kundërvajtjeve.

2 Në këto shifra nuk janë përfshirë vendimet e njejta që janë evidentuar gjatë monitorimit si dhe procesverbalet e publikuara nga ana e gjykatave, që gjithsej përbëjnë 73 vendime të tilla.

- **Gjykata Themelore e Gjakovës**, e cila gjatë këtij viti ka zgjidhur 8,045 lëndë, ndërsa ka publikuar 4,857 vendime (60% të lëndëve).
- Ndërsa gjykatat të cilat kanë publikuar më pak vendime gjyqësore për vitin 2023 janë:
- **Gjykata Themelore e Prishtinës**, e cila gjatë këtij viti ka zgjidhur 26,942 lëndë, ndërsa ka publikuar vetëm 3,769 vendime (14% të lëndëve);
  - **Gjykata Themelore e Pejës**, e cila gjatë këtij viti ka zgjidhur 11,077 lëndë, ndërsa ka publikuar vetëm 1,969 vendime (18% të lëndëve); si dhe
  - **Gjykata Themelore e Mitrovicës**, e cila gjatë këtij viti ka zgjidhur 9,646 lëndë, ndërsa ka publikuar vetëm 2,382 vendime (25% të lëndëve);
- Degët e gjykatave me më së shumti vendime të publikuara në proporcion me lëndët e zgjidhura gjatë periudhës së monitorimit janë:
- **Dega e Novobërdes**, e cila gjatë këtij viti ka zgjidhur 642 lëndë, ndërsa ka publikuar 470 vendime (73 % të lëndëve);
  - **Dega e Rahovecit**, e cila gjatë këtij viti ka zgjidhur 2,170 lëndë, ndërsa ka publikuar 1,174 vendime (54 % të lëndëve);
  - **Dega e Kaçanikut**, e cila gjatë këtij viti ka zgjidhur 1,210 lëndë, ndërsa ka publikuar 648 vendime (54 % të lëndëve).
- Gjyqtarët e Gjykatës Themelore të Gjakovës dhe të Gjykatës Themelore të Ferizajt prijnë me numrin e vendimeve të publikuara gjatë kësaj periudhe. I pari në renditje qëndron gjyqtari *Durim Balaj*, i cili gjatë kësaj periudhe ka publikuar 946 vendime. Më pas renditet gjyqtari *Faton Ajvazi*, i cili ka publikuar 865 vendime, si dhe gjyqtarja nga Gjykata Themelore e Gjakovës, *Mirjeta Shala*, me 751 vendime të publikuara.
- Gjatë kësaj periudhe një vjeçare, nga numri i përgjithshëm i vendimeve të publikuara, 24% janë vendime të natyrës penale; 60% janë vendime të natyrës civile; 7% janë administrative; ekonomike 8% dhe fiskale 1%.
- Gjatë kësaj periudhe janë publikuar 99 vendime të keqpërdorimit të detyrës zyrtare, numër ky që ishte rritur ndjeshëm në raport me vitin 2022 (ku ishin publikuar 93 lëndë të tilla). Ndërkaq gjatë monitorimi janë evidentuar edhe 103 vendime të dhunës në familje<sup>3</sup>.
- Gjykatat të cilat kanë publikuar më së shumti lëndë sa i përket veprave penale të dhunës në familje, janë: *Gjykata Themelore e Prishtinës* (41 vendime), *Gjykata Themelore e Mitrovicës* (22 vendime), dhe *Gjykata Themelore e Gjakovës* (22 vendime). Ndërsa gjykatat të cilat kanë publi-

<sup>3</sup> Bazuar në nenin 370, par.2 të KPPK-së, lëndët që kanë të bëjnë me veprat penale në kuadër të marrëdhënieve familjare nuk duhet të publikohen.

kuar më së shumti lëndë nga veprat penale të korrupsionit janë: *Gjykata Themelore e Prishtinës* (53 vendime), *Gjykata e Apelit* (28 vendime), dhe *Gjykata Themelore e Mitrovicës* (15 vendime).














- Gjatë kësaj periudhe të monitorimit, zbatimi në përpikmëri i Vendimit të KGJK-së për Standardizimin e Formave të Vendimeve është evidentuar në 34,276 vendime, apo në 85% të të gjitha vendimeve të publikuara. Në pjesën tjetër prej 6,153 vendimesh, përkatësisht në 15% të tyre, është vërejtur ngecje në zbatimin e këtij vendimi.
- Gjatë kësaj periudhe, 98% e vendimeve janë publikuar në gjuhën shqipe, ndërsa vetëm 2% e vendimeve janë publikuar në gjuhën serbe, ndryshe nga viti 2022 ku ishin publikuar 5% e vendimeve në gjuhën serbe.
- Gjykatave u janë dashur mesatarisht 57 ditë për t'i publikuar vendimet në ueb-faqen zyrtare të KGJK-së, llogaritur nga dita e shpalljes së tyre, që nënkupton se gjykatat në përgjithsi e kanë respektuar afatin e paraparë me ligj për publikimin e tyre. Më së shumti kohë në publikimin e vendimeve llogaritur nga dita e nxjerrjes i janë dashur *Gjykatës Themelore të Prishtinës*, (mesatarisht 117 ditë), *Gjykatës Themelore në Pejë* (mesatarisht 68 ditë) dhe *Gjykatës Themelore të Mitrovicës* (mesatarisht 61 ditë). Ndërsa, *Gjykata Themelore e Gjilanit*, *Gjykata Themelore e Ferizajt* dhe *Gjykata Supreme* këtë afat e kanë respektuar në përpikmëri.
- Ueb-faqja e Këshillit Gjyqësor të Kosovës ende ka probleme të natyrës teknike sa i përket numërimit automatik të aktgjyqimeve. Kjo për shkak se, nëse numërohen manualisht në baza mujore të gjitha aktgjykimet e publikuara, numri rezulton të jetë më i lartë, se numri total i aktgjyqimeve të numëruara automatikisht nga sistemi i ueb-faqes.



Në tabelën në vijim janë paraqitur të dhënat në lidhje me numrin e lëndëve të zgjidhura si dhe të vendimeve të publikuara në ueb-faqen zyrtare të KGjK-së gjatë periudhës janar-dhjetor 2023 nga të gjitha Gjykatat e Republikës së Kosovës.

**TABELA 1**

Lëndët e zgjidhura dhe vendimet e publikuara nga të gjitha gjykatat e Republikës së Kosovës në ueb -faqen e Keshillit Gjyqësor të Kosovës gjatë periudhës janar-dhjetor 2023.

Gjykatat e Republikës së Kosovës	Numri i lëndëve të zgjidhura	Raporti ndërmjet lëndëve të zgjidhura dhe atyre të publikuara, e shprehur në %.	Numri i aktgjytimeve të publikuara
Gjykata Supreme	Gjykata Supreme	1,849 	1,135
	Dhoma e Posaçme	3,193 	1,849
Gjykata e Apelit	17,690 	7,558	
Gjykata Themelore e Prishtinës	25,665 	3,769	
Gjykata Themelore e Ferizajt	8,611 	3,005	
Gjykata Themelore e Mitrovicës	9,646 	2,382	
Gjykata Themelore e Prizrenit	12,679 	4,618	
Gjykata Themelore e Gjakovës	8,045 	4,857	
Gjykata Themelore e Pejës	11,077 	1,969	
Gjykata Themelore e Gjilanit	11,933 	4,817	
Gjykata Komerçiale	Shkalla I	4,017 	2,755
	Shkalla II	2,222 	1,710
<b>TOTAL</b>	<b>116,629</b> 	<b>40,424</b>	

Ndërsa në tabelën e mëposhtme janë paraqitur të dhënat në lidhje me numrin e lëndëve të zgjidhura si dhe të vendimeve të publikuara në ueb-faqen zyrtare të KGJK-së gjatë periudhës janar-dhjetor 2023 nga të gjitha degët e Gjykatave të Republikës së Kosovës.

TABELA 2

Lëndët e zgjidhura dhe vendimet e publikuara nga të gjitha degët e Gjykatave të Republikës së Kosovës në ueb-faqen e Keshillit Gjyqësor të Kosovës gjatë periudhës janar-dhjetor 2023.

Gjykata themelore	Degët e gjykatave themelore	Numri i lëndëve të zgjidhura	Numri i aktgjykimeve të publikuara	Raporti ndërmjet lëndëve të zgjidhura dhe atyre të publikuara, e shprehur në %.
Gjykata Themelore në Prishtinë	Dega në Podujevë	2,834	424	15%
	Dega në Gracanicë	632	18	3%
	Dega në Lipjan	2,470	718	29%
	Dega në Glogoc	1,759	253	14%
	Dega në Fushë Kosovë	637	0	0 %
Gjykata Themelore në Gjilan	Dega në Kamenicë	1,345	547	41%
	Dega në Viti	3,422	893	26%
	Dega në Novobërdë	642	470	73%
Gjykata Themelore në Prizren	Dega në Suharekë	2,129	437	21%
	Dega në Dragash	724	188	26%
Gjykata Themelore në Mitrovicë	Dega në Leposaviq	107	7	7%
	Dega në Vushtrri	3,293	924	28%
	Dega në Zubin Potok	14	1	7%
	Dega në Skenderaj	1,445	563	39%
Gjykata Themelore në Gjakovë	Dega në Malishevë	1,672	840	50%
	Dega në Rahovec	2,170	1,174	54%
Gjykata Themelore në Pejë	Dega në Istog	1,857	653	35%
	Dega në Klinë	1,077	326	30%
	Dega në Deçan	1,486	164	11%
Gjykata Themelore në Ferizaj	Dega në Kaçanik	1,210	648	54%
	Dega në Shtrëpcë	401	99	25%
<b>TOTAL</b>		<b>87,659</b>	<b>9,347</b>	<b>11%</b>

# Totali i lëndëve të zgjidhura nga të gjitha Gjykatat e Republikës së Kosovës gjatë periudhës janar-dhjetor 2023



## 2. Metodologjia

Ky raport ka për qëllim që të paraqes gjendjen faktike të publikimit të aktgjykimeve dhe aktvendimeve nga ana e gjykatave të Republikës së Kosovës, të identifikoj problemet dhe sfidat në publikimin e tyre, si dhe të ofroj një listë rekomandimesh për veprimet që organet gjyqësore duhet të ndër marrin për të përmirësuar shkallën dhe cilësinë e publikimit të këtyre vendimeve.

Lëvizja FOL për përpilimin e të dhënave të këtij raporti ka përdorur metodën e monitorimit të vazhdueshëm sistematik të të gjitha aktgjykimeve dhe aktvendimeve të publikuara në ueb-faqen zyrtare të Këshillit Gjyqësor të Kosovës.

Paraprakisht, të gjitha gjykatat janë informuar përmes e-mailit se do të jenë subjekt i monitorimit për dinamikën e publikimit të vendimeve gjyqësore, si dhe nëse publikimi i vendimeve është bërë konform kërkesave ligjore, udhëzimeve administrative dhe të vendimeve tjera relevante në fuqi. Të dhënat e mbledhura nga ky proces i monitorimit janë projektuar në formë infografikash dhe janë publikuar për çdo muaj në rrjetet sociale të Lëvizjes FOL.

Nga vendimet e publikuara në ueb-faqen e Këshillit Gjyqësor të Kosovës, Lëvizja FOL ka krijuar një databazë me të dhëna. Rrjedhimisht, vendimet e njejta të evidentuara gjatë kësaj periudhe nuk janë bashkangjitur në këtë databazë. Kjo databazë, ndër të tjera, përfshinë:

- numrin e përgjithshëm të aktgjykimeve dhe aktvendimeve të publikuara nga çdo gjykatë, për çdo muaj;
- nivelin e respektimit të protokolleve dhe afateve të parapara me aktet nënligjore për publikimin e vendimeve, si dhe pajtueshmëria e aktgjykimeve/aktvendimeve të publikuara me Ligjin për Gjykatat dhe udhëzimet administrative;
- mbrojtjen e të dhënave personale të palëve dhe specifikat tjera të cilat rregullohen me ligj dhe akte të tjera;
- gjyqtarët që kanë publikuar më së shumti vendime;
- nivelin e zbatimit të Vendimit për Standardizimin e Formave të Vendimeve (vendosjen e llogos së Republikës së Kosovës, formati i duhur i vendimit);
- gjuhën në të cilën janë publikuar vendimet, si dhe
- llojin dhe natyrën e vendimeve të publikuara.

Për të nxjerrur një përqindje të saktë të nivelit të publikimit të vendimeve gjyqësore nga gjykatat përkatëse, duhet ditur edhe numrin e lëndëve që kanë marrur epilog gjyqësor gjatë periudhës së monitorimit. Prandaj, FOL ka krahasuar numrin e lëndëve të zgjidhura gjatë periudhës së monitorimit për secilën gjykatë me numrin e lëndëve të publikuara në secilën gjykatë gjatë asaj periudhe.

Për t'a arritur këtë, numri i lëndëve të zgjidhura nga të gjitha gjykatat dhe degët e tyre është nxjerrur nga Raporti Statistikor i Këshillit Gjyqësor të Kosovës për vitin 2023.<sup>4</sup>

<sup>4</sup> Këshilli Gjyqësor i Kosovës, Departamenti i Statistikave, Raporti Statistikor Vjetor i Gjykatave për vitin 2023.

Në mënyrë që të reflektohet përqindja e saktë e shkallës së publikimit të vendimeve, nga numri i lëndëve të zgjidhura për secilën gjykatë janë zbritur:

- vendimet për të mitur (publikimi i të cilave është përjashtuar me Kodin Nr. 24 / 17 e Procedurës Penale, 370 par. 2); dhe
- vendimet për kundërvajtje (publikimi i të cilave është përjashtuar me Udhëzimin Administrativ nr. 04/2019 për publikimin e Aktgjykimeve të Përpunuara, neni 2, par. 1.4).

Me KPP dhe udhëzimin në fuqi janë përjashtuar nga publikimi edhe disa kategori të tjera të lëndëve (*veprat penale të kryera në kuadër të marrëdhënies familjare, veprat penale kundër integritetit seksual, aktgjykimet nga kontestet martesore, si dhe aktgjykimet për mbajtje financiare dhe ushqimi, vërtetim apo kundërshtim të atësisë, dhe kujdestari të personit të mitur*). Mirëpo në raportin statistikor të KGJK-së, këto lëndë nuk kanë qenë të kategorizuara, prandaj nuk ka qenë e mundur zbritja e tyre nga numri total i lëndëve të zgjidhura.

Me qëllim që të dhënat në këtë raport të jenë sa më të sakta dhe të plota, para publikimit ky raport i është dërguar zyrtarëve për informim të të gjitha gjykatave për komente eventuale, të cilat janë përfshirë në raportin përfundimtar.

### 3. Baza ligjore e publikimit të vendimeve gjyqësore

Parimi i gjykimit publik, pra gjykimit me dyer të hapura, është inkorporuar edhe në Kushtetutën e Republikës së Kosovës<sup>5</sup>, ku në nenin 31 të saj parashihet se gjykimi është publik, me përjashtim të rasteve kur gjykata konsideron se në të mirë të drejtësisë është i domosdoshëm përjashtimi i publikut.

Me qëllim të përmbushjes së këtij parimi, Ligji për Gjykatat (Nr. 06/L – 054)<sup>6</sup> që u miratua në dhjetor të vitit 2018 dhe që është aktualisht në fuqi, ka bërë progres në rritjen e transparencës së gjyqësorit, duke e bërë të detyrueshme për të gjitha gjykatat publikimin e të gjitha vendimeve brenda 60 ditësh nga data e nxjerrjes së aktgjykimit në faqet e tyre të internetit. Pra ky ligj i ka obliguar gjykatat që të publikojnë të gjitha vendimet, pavarësisht plotfuqishmërisë ligjore, ndryshe nga ligji paraprak, i cili i obligonte gjykatat të publikojnë vetëm vendimet e formës së prerë.

Kodi nr. 08/l-032 i Procedurës Penale, i cili hyri në fuqi në shkurt të vitit 2023, në nenin 370 të tij rregullon çështjen e publikimit të aktgjykimeve. Në paragrafin 2 të këtij neni është paraparë përjashtim në publikimin e aktgjykimeve në rastet kur të miturit janë të përfshirë si palë, në rastet kur pretendohet se veprat penale janë kryer në kuadër të marrëdhënieve familjare apo në rastet e veprave penale kundër integritetit seksual.

Gjithashtu, Kodi i ri i Procedurës Penale, kishte paraparë se përveç numrit personal, datës së lindjes, emrit të prindërve dhe vendlindjes, publikimi i të dhënave të tjera personale, nuk konsiderohet shkelje e privatësisë, për shkak të interesit të publikut për një gjyqësor të hapur dhe publik.<sup>7</sup>

Për të përmirësuar cilësinë e vendimeve dhe për t'u siguruar që ato t'i përmbajnë elementet thelbësore, Këshilli Gjyqësor i Kosovës në vitin 2018 nxori *Vendimin për Standardizimin e Formave të Vendimeve* dhe krijoi grupin punues për krijimin e *Shabllonit për Standardizimin e Formave*.

Për mbrojtjen e të dhënave personale gjatë publikimit të vendimeve, Këshilli Gjyqësor i Kosovës në fund të vitit 2019 ka nxjerrë *Udhëzimin e ri Administrativ për Publikimin e Vendimeve të Përpunuara dhe Manualin për Publikimin dhe Përpunimin e Vendimeve*. Në fund të vitit 2021 ky udhëzim pësoj disa ndryshime. Përkatësisht, në dhjetor të vitit 2021, Këshilli Gjyqësor i Kosovës ka nxjerrë Udhëzimin Administrativ nr. 01/2021<sup>8</sup> për plotësimin dhe ndryshimin e *Udhëzimit Administrativ 04/2019 për Publikimin e Vendimeve të Përpunuara*. Si një prej ndryshimeve esenciale të parapara në këtë ndryshim/plotësim, ishte se përveç vendimeve, gjykatat obligohen të publikojnë edhe aktvendimet meritore.

5 Kushtetuta e Republikës së Kosovës, 2008, neni 31.

6 Ligji Nr. 06/L – 054 për Gjykatat, 2018, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës.


7 Kodi nr. 08/l-032 i Procedurës Penale, neni 369, par. 13.

8 [https://ëëë.gjyqesori-rks.org/ëp-content/uploads/lgsl/60388\\_Udhëzim\\_Administrativ\\_Nr\\_01\\_2021\\_per\\_plotësimin\\_dhe\\_ndryshimin\\_Udhëzimit\\_Administrativ\\_04\\_2019\\_per\\_publicimin\\_vendimeve\\_te\\_perpunuara.pdf](https://ëëë.gjyqesori-rks.org/ëp-content/uploads/lgsl/60388_Udhëzim_Administrativ_Nr_01_2021_per_plotësimin_dhe_ndryshimin_Udhëzimit_Administrativ_04_2019_per_publicimin_vendimeve_te_perpunuara.pdf)

Me funksionalizimin e Gjykatës Komerciale, KGJK në fund të vitit 2022 miratoi *Udhëzimin Administrativ Nr. 01/2022 për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit Administrativ Nr. 01/2021 për plotësimin dhe ndryshimin e Udhëzimit Administrativ 04/2019 për Publikimin e Vendimeve të Përpunuara*<sup>9</sup>, ku obligoi edhe Gjykatën Komerciale që të publikoj të gjitha vendimet, sipas akteve në fuqi.


---

<sup>9</sup> [https://www.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/decisions/30130\\_Vendimi\\_KGJK\\_se\\_Nr\\_510\\_2022.pdf](https://www.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/decisions/30130_Vendimi_KGJK_se_Nr_510_2022.pdf)




# Gjykata Supreme

Lëndët e zgjidhura



1,848

Vendime të publikuara



1,135

FIGURA 1

Raporti ndërmjet lëndëve të zgjidhura dhe vendimeve të publikuara në Gjykatën Supreme gjatë periudhës janar-dhjetor 2023.

Gjykata Supreme gjatë periudhës janar-dhjetor 2023 ka publikuar gjithsej 1,135 vendime gjyqësore. Ky nivel i publikimit dëshmon rritje të ndjeshme të publikimit në krahasim me vitin paraprak, ku Gjykata Supreme kishte publikuar gjithsej 1,093 vendime gjyqësore, përkatësisht rritje për 4%.


Në krahasim me numrin e lëndëve të zgjidhura nga kjo gjykatë gjatë vitit 2023, që gjatë kësaj periudhe ishin gjithsej 1,848 lëndë, kjo gjykatë (pa përfshirë Dhomën e Posaçme) ka arritur të publikoj 61% të vendimeve nga lëndët që gjatë këtij viti kishin marrur epilog gjyqësor. Me këtë shkallë të publikimit të lëndëve të zgjidhura, kjo gjykatë renditet e dyta me rradhë në kuadër të të gjitha gjykatave sa i përket nivelit të publikimit në raport me zgjidhjen e tyre.

Ndërkaq Dhoma e Posaçme e kësaj gjykate gjatë periudhës janar-dhjetor 2023 ka zgjidhur 3,193 lëndë, ndërsa ka publikuar 1,849 aktgjykime, përkatësisht 58% të vendimeve gjyqësore të nxjerrura gjatë kësaj periudhe.

## Dhoma e Posaçme

FIGURA 2

Raporti ndërmjet lëndëve të zgjidhura dhe vendimeve të publikuara në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme gjatë periudhës janar-dhjetor 2023.



3,193




1,849




Në figurën e mëposhtëm është pasqyruar shkalla e publikimit të vendimeve nga Gjykata Supreme gjatë periudhës janar – dhjetor 2023, për secilin muaj të këtij viti. Sipas figurës së mëposhtme, shihet se numrin më të madh të aktgjykimeve i ka publikuar gjatë muajit dhjetor, ndërsa numrin më të vogël gjatë muajit gusht.

**FIGURA 3** Niveli i publikimit të vendimeve gjatë periudhës janar-dhjetor 2023 në Gjykatën Supreme.




Ndërkaq publikimi i vendimeve nga Dhoma e Posaçme për çdo muaj kalendarik gjatë vitit 2023 në mënyrë grafike është paraqitur në figurën e mëposhtme. Nga kjo figurë mund të shihet se numrin më të madh të vendimeve gjyqësore kjo njësi e ka publikuar në muajin dhjetor.

**FIGURA 4** Niveli i publikimit të vendimeve nga Dhoma e Posaçme gjatë periudhës janar-dhjetor 2023.



Pjesa më e madhe e vendimeve të publikuara nga Gjykata Supreme janë të natyrës civile, respektivisht 2,349 vendime civile, 319 prej tyre janë të natyrës penale, 316 vendime të natyrës administrative. Në grafikën në vijim është paraqitur lloji i vendimeve të publikuara nga Gjykata Supreme.



Nga numri i përgjithshëm i vendimeve të publikuara, gjatë kësaj periudhe të monitorimit Gjykata Supreme ka publikuar 8 vendime në lidhje me veprat penale të korrupsionit.

Ndërsa sa i përket gjuhës në të cilën janë publikuar vendimet, 2,689 vendime apo 90% e tyre janë publikuar në gjuhën shqipe, ndërsa 295 vendime apo 10% prej tyre janë publikuar në gjuhën serbe. Gjuha në të cilën janë publikuar vendimet nga kjo gjykatë është paraqitur në mënyrë grafike në figurën e mëposhtme.




Kërkesat e përcaktuara në *Vendimin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës për Standardizimin e Formave të Aktgjykimeve* nga kjo gjykatë janë zbatuar në nivel të kënaqshëm. Nga numri i përgjithshëm i vendimeve të publikuara, në 2,326 vendime është zbatuar ky vendim, apo në 78% ndërsa në pjesën tjetër prej 657 vendimesh apo 22% janë evidentuar lëshime në zbatimin e tij.

Në tabelën e mëposhtme është shprehur në mënyrë grafike zbatimi i Vendimit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës për Standardizimin e Formave të Vendimeve në vendimet e publikuara nga Gjykata Supreme.

**FIGURA 7**

Përdorimi i Shabllonit për Standardizimin e Formave të Vendimeve në vendimet e publikuara nga Gjykata Supreme gjatë periudhës janar-dhjetor 2023.



Ndërkaq *Udhëzimi Administrativ për Publikimin e Vendimeve të Përpunuara* është zbatuar në nivel të lartë në shumicën e vendimeve të publikuara nga kjo gjykatë. Nga 2,984 aktgjykime të publikuara për periudhën janar-dhjetor 2023, të dhënat personale janë fshehur me përpikmëri në 2,917 vendime, ndërsa në 67 vendime janë evidentuar lëshime në këtë aspekt.

Nga monitorimi i publikimit të vendimeve të Gjykatës Supreme është vërejtur se kësaj gjykate i janë dashur mesatarisht 45 ditë për t'i publikuar vendimet, llogaritur nga dita e shpalljes, pra konform kërkesave ligjore.

Gjyqtarët që kanë publikuar më shumë vendime në Gjykatën Supreme, si dhe numri i vendimeve të publikuara nga ta gjatë periudhës janar-dhjetor 2023 janë paraqitur në tabelën e mëposhtme.

Pra, nga tabela e vendosur më sipër, shihet se gjyqtarët e Gjykatës Supreme me më së shumti vendime të publikuara janë: Gazmend Sylaj (243 vendime të publikuara) nga Dhoma e Posaçme; Sahit Sylejmani (236 vendime të publikuara) nga Dhoma e Posaçme; si dhe Sabri Halili (205 vendime të publikuara) nga Dhoma e Posaçme.

FIGURA 8

Gjyqtarët me më së shumti vendime të publikuara në Gjykatën Supreme gjatë periudhës janar-dhjetor 2023.






# Gjykata e Apelit


Lëndët e zgjidhura



Vendime të publikuara



17,690



7,558



## FIGURA 9


Raporti ndërmjet lëndëve të zgjidhura dhe vendimeve të publikuara në Gjykatën e Apelit gjatë periudhës janar-dhjetor 2023.

Gjykata e Apelit gjatë periudhës janar - dhjetor 2023 ka publikuar gjithsej 7,558 vendime gjyqësore. Nëse nuk merret parasysh raporti me numrin e lëndëve të zgjidhura gjatë kësaj periudhe, me këtë nivel të publikimit të vendimeve, kjo gjykatë renditet në vendin e parë për nga numri i publikimeve. Në krahasim me vitin paraprak, kur kjo gjykatë kishte publikuar 7,451 vendime gjyqësore, përkatësisht rreth 50% të lëndëve të zgjidhura, rezulton se ky numër i publikimit të vendimeve në këtë vit ka shënuar rritje për 1.4%.

Ndërsa në raport me lëndët e zgjidhura gjatë vitit 2023 (17,690 lëndë), rezulton se kjo gjykatë ka arritur që gjatë kësaj periudhe të publikoj 43% të lëndëve të zgjidhura.


Në figurën e mëposhtme është paraqitur niveli i publikimit të vendimeve nga Gjykata e Apelit gjatë periudhës janar – dhjetor 2023. Sipas kësaj figure, nivelin më të madh të publikimit të aktgjyqimeve kjo gjykatë e ka arritur gjatë muajit nëntor dhe dhjetor.

**FIGURA 10** Niveli i publikimit të vendimeve gjatë periudhës janar-dhjetor 2023 në Gjykatën e Apelit.




Sa i përket natyrës së lëndëve, edhe Gjykata e Apelit ka publikuar më shumë vendime të natyrës civile. Nga totali i përgjithshëm i vendimeve të publikuara, 5,546 prej tyre janë të natyrës civile, 1,365 sosh të natyrës penale, 596 të natyrës administrative, dhe 51 vendime të natyrës ekonomike.

Në tabelën e mëposhtme është përshkruar publikimi i vendimeve të Gjykatës së Apelit, të ndarë sipas llojit të lëndëve.




Gjykata e Apelit gjatë kësaj periudhe ka publikuar 28 vendime në lidhje me veprat penale të korrupsionit, ndërsa 2 vendime të dhunës në familje.

Ndërsa sa i përket gjuhës në të cilën janë publikuar vendimet, Gjykata e Apelit ka publikuar 7,389 apo 98% të vendimeve në gjuhën shqipe, ndërsa në gjuhën serbe 169 aktgjykimve apo 2%. Gjuha e publikimit të aktgjykimve në mënyrë grafike është paraqitur në figurën e mëposhtme.



Zbatimi i Vendimit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës për Standardizimin e Formave të Vendimeve nga kjo gjykatë është arritur në nivel jo shumë të kënaqshëm. Në pjesën prej 4,532 vendimesh vendimi është zbatuar në përpikmëri, ndërsa në 3,026 vendime ky vendim nuk është zbatuar në mënyrën e përcaktuar në këtë vendim.

Në figurën në vijim është paraqitur niveli i zbatimit të Vendimit për Standardizimin e Formave të Vendimeve në vendimet e publikara nga Gjykata e Apelit.



Sa i përket respektimit të Udhëzimit Administrativ për Publikimin e Aktgjykimeve të Përpunuara, Gjykata e Apelit nga 7,558 vendime, 50 prej tyre i ka publikuar pa u`a fshehur të dhënat personale subjekteve që kërkohet me këtë udhëzim.

Nga monitorimi i publikimit të vendimeve të Gjykatës së Apelit është vërejtur se kësaj gjykate i janë dashur mesatarisht 59 ditë për t'i publikuar vendimet. Nëse e krahasojmë me vitin 2022, kjo gjykatë këtë vit ka shënuar progres sa i përket publikimit të vendimeve në kohë, kështu duke e ulur mesataren e publikimit për dyfish më pak.

Ndërkaq gjyqtarët me më së shumti vendime të publikuara nga Gjykata e Apelit gjatë kësaj periudhe, janë paraqitur në tabelën e mëposhtme.

FIGURA 14

Gjyqtarët me më së shumti vendime të publikuara në Gjykatën e Apelit gjatë periudhës janar-dhjetor 2023.




Pra, nga tabela e vendosur më sipër, shihet se gjyqtarët e Gjykatës së Apelit me më së shumti vendime të publikuara janë: Besnik Feka (405 vendime të publikuara), Lumni Sallauka (389 vendime të publikuara), si dhe Rafet Haxhaj (387 vendime të publikuara).





# Gjykata Komercciale




Gjykata Komercciale së bashku me *Dhomën e Shkallës së Parë dhe Dhomën e Shkallës së Dytë* ka publikuar 4,465 vendime gjyqësore për periudhën janar-dhjetor 2023, numër ky që ishte rritur shumëfish në krahasim me vitin 2022, kur kjo gjykatë kishte publikuar 422 vendime gjyqësore.

Dhoma e Shkallës së Parë e kësaj gjykate ka publikuar 2,755 vendime, nga 4,017 lëndë sa i ka zgjidhur gjithsej (69% të lëndëve), ndërsa Dhoma e Shkallës së Dytë i ka publikuar 1,710 vendime nga 2,222 lëndë sa i ka zgjidhur gjithsej (77% të lëndëve).

Me këto shifra të publikimit në raport me lëndët e zgjidhura, kjo gjykatë renditet e para për nga niveli i publikimit gjatë vitit 2023.


Niveli i publikimit të vendimeve nga *Dhoma e Shkallës së Parë* dhe *Dhoma e Shkallës së Dytë* për secilin muaj të kësaj periudhe është shfaqur në mënyrë grafike në tabelën e mëposhtme. Siç mund të shihet nga kjo figurë, Dhoma e Shkallës së Parë më së shumti aktgjykime ka publikuar në muajin korrik, ndërsa Dhoma e Shkallës së Dytë më së shumti aktgjykime ka publikuar në muajin gusht.

**FIGURA 16** Niveli i publikimit të vendimeve nga Dhoma e shkallës së parë dhe Dhoma e Shkallës së dytë gjatë periudhës janar-dhjetor 2023.



Sa i përket llojit të vendimeve të publikuara, Gjykata Komeriale për këtë periudhë ka publikuar 3,399 vendime të natyrës ekonomike, 624 vendime të natyrës administrative dhe 442 vendime të natyrës fiskale.

Lloji i vendimeve të publikuara është paraqitur në mënyrë grafike në figurën e mëposhtme.




Nga numri i përgjithshëm i publikimit të vendimeve, Gjykata Komeriale ka publikuar 4 vendime gjyqësore në gjuhën serbe (0,1%) dhe 4,459 vendime në gjuhën shqipe (99.9%).

Gjuha e vendimeve të publikuara është paraqitur edhe në grafikën e mëposhtme.



Vendimi i Këshillit Gjyqësor të Kosovës për Standardizimin e Formave të Aktgjykimeve është zbatuar në mënyrë të kënaqshme nga kjo gjykatë, për shkak se vetëm 14 vendime janë evidentuar jashtë rregullave që i parasheh ky vendim.

Zbatimi i Vendimit për Standardizimin e Formave të Aktgjykimeve, në mënyrë grafike është paraqitur në tabelën e mëposhtme.



Nga monitorimi i publikimit të vendimeve të Gjykatës Komeriale është vërejtur se kësaj gjykate i janë dashur mesatarisht 50 ditë për t'i publikuar vendimet, llogaritur nga dita e shpalljes. Pra, kjo gjykatë aktgjykimet i ka publikuar konform kohës së paraparë në dispozitat gjyqësore.

Gjyqtarët me më së shumti aktgjykime të publikuara nga Gjykata Komeriale janë paraqitur në grafikën e mëposhtme.

FIGURA 20

Gjyqtarët me më së shumti vendime të publikuara në Gjykatën Komeriale gjatë periudhës janar-dhjetor 2023.



Pra, nga tabela e vendosur më sipër, shihet se gjyqtarët e Gjykatës Komeriale me më së shumti vendime të publikuara janë: Florent Zeqiri (398 vendime të publikuara) nga Dhoma e Shkallës së Parë, Arbër Rexha (360 vendime të publikuara) nga Dhoma e Shkallës së Parë, si dhe Verona Dibra (350 vendime të publikuara) nga Dhoma e Shkallës së Parë.




# Gjykata Themelore e Prishtinës

Lëndët e zgjidhura



Vendime të publikuara



## FIGURA 21

Raporti ndërmjet lëndëve të zgjidhura dhe vendimeve të publikuara në Gjykatën Themelore të Prishtinës gjatë periudhës janar-dhjetor 2023.

Gjykata Themelore e Prishtinës, duke përfshirë 4 degët e saj (Dega në Podujevë, Dega në Graçanicë, Dega në Lipjan, Dega në Glogoc, Dega në Fushë Kosovë<sup>10</sup>), gjatë kësaj periudhe ka publikuar 3,769 vendime.<sup>11</sup> Ky nivel i publikimit të kësaj gjykate ka rënë dukshëm (-34%), në krahasim me vitin 2022, kur kjo gjykatë kishte publikuar 5,784 aktgjykime.

Gjykata Themelore e Prishtinës (si dhe degët e saj) gjatë vitit 2023 kishte zgjidhur 25,665 lëndë, dhe rrjedhimisht nga të dhënat e monitorimit rezultojnë se kjo gjykatë ka publikuar vetëm rreth 15 % të vendimeve nga lëndët që gjatë këtij viti kishin marrur epilog gjyqësor.


<sup>10</sup> Dega e Fushë Kosovës ka filluar punën në muajin Korrik të vitit 2023.

<sup>11</sup> Gjatë monitorimit të vendimeve në ueb-faqen e KGJK-së në këtë gjykatë janë evidentuar edhe 38 vendime të tjera të përsëritura dhe procesverbale, që nuk janë përfshirë në këto shifra.

Në grafikën në vijim janë paraqitur të dhënat mbi numrin e vendimeve të publikuara nga Gjykata Themelore e Prishtinës gjatë periudhës janar – dhjetor 2023, të ndara në muaj. Nga kjo figurë mund të shihet se numrin më të madh të aktgjykimeve kjo gjykatë i ka publikuar gjatë muajit prill.

FIGURA 22

Niveli i publikimit të vendimeve në Gjykatën Themelore të Prishtinës gjatë periudhës janar-dhjetor 2023.



Në këtë numër të publikimit të vendimeve nga kjo gjykatë, kanë kontribuar edhe degët e kësaj gjykate. Të gjitha degët e kësaj gjykate në tërësi kanë publikuar 1,413 vendime, përkatësisht 37% të vendimeve të publikuara nga kjo gjykatë si tërësi.

Dega e Lipjanit gjatë kësaj periudhe ka publikuar 718 vendime nga 2,470 lëndë të zgjidhura (29%), Dega e Podujevës 424 vendime, nga 2,834 lëndë të zgjidhura (15%), Dega e Glllogovcit 253 vendime nga 1,759 lëndë të zgjidhura (14%), Dega e Graçanicës ka publikuar vetëm 18 aktgjykime nga 632 lëndë të zgjidhura (3%), ndërsa Dega e Fushë Kosovës nuk ka publikuar asnjë vendim përkundër faktit se ka arritur të zgjidhë 637 lëndë<sup>12</sup>.


Nëse e krahasojmë me vitin e kaluar, Dega e Glllogovcit ka dukshëm më pak vendime të publikuara për këtë vit, përkatësisht 597 vendime më pak. Ndërsa, Dega e Graçanicës ka shënuar një rritje të limituar, për shkakun se vitin e kaluar ka pasur vetëm 1 vendim të publikuar ndërsa këtë vit 18 vendime të publikuara.

Shifrat e publikimit të degëve të Gjykatës Themelore në Prishtinë gjatë muajve të këtij viti në mënyrë grafike janë paraqitur edhe në figurën në vijim.

<sup>12</sup> Kjo dëgë ka filluar zyrtarisht punën me 4 korrik të vitit 2023.


**FIGURA 23**

Niveli i publikimit të vendimeve nga degët e Gjykatës Themelore të Prishtinës gjatë periudhës janar-dhjetor 2023.



Ndërkaq sa i përket llojit të vendimeve të publikuara, Gjykata Themelore e Prishtinës prinë me publikimin e vendimeve të natyrës penale. Respektivisht, nga numri i përgjithshëm i publikimit, 1,474 vendime janë të natyrës penale, 1,150 të natyrës civile, dhe 1,145 prej tyre administrative.

Ky klasifikim i vendimeve të publikuara nga Gjykata Themelore e Prishtinës është pasqyruar edhe në grafikën e mëposhtme.



Nga vendimet penale, 37 vendime janë për veprat penale të keqpërdorimit të pozitës dhe autoritetit zyrtar, ndërsa 41 vendime të dhunës në familje.

Gjykata Themelore në Prishtinë ka publikuar 14 aktgjykime në gjuhën serbe (0.38%), ndërsa pjesa tjetër e vendimeve janë publikuar në gjuhën shqipe. Në mënyrë grafike, gjuha e publikimit të aktgjykimeve është paraqitur edhe në tabelën e mëposhtme.






Vendimi për Standardizimin e Formave të Aktgjykimeve është zbatuar në masë të konsiderueshme nga kjo gjykatë. Nga numri i përgjithshëm i vendimeve të publikuara, ky vendim është zbatuar në 3,512 vendime, ndërsa në 257 vendime të tjera janë vërejtur lëshime në zbatimin e tij. Në tabelën e mëposhtme është paraqitur në mënyrë grafike zbatimi i këtij akti në vendimet e publikuara të kësaj gjykate.

**FIGURA 26**

Niveli i zbatimit të Vendimit për Standardizimin e Formave të Vendimeve nga Gjykata Themelore e Prishtinës gjatë periudhës janar-dhjetor 2023.



Ndërkaq sa i përket fshehjes së të dhënave personale, nga numri i përgjithshëm i vendimeve të publikuara, 208 vendime janë publikuar të pa-anonimizuara (6%).

Nga monitorimi i publikimit të vendimeve të Gjykatës Themelore në Prishtinë është vërejtur se kësaj gjykate i janë dashur mesatarisht 117 ditë për ti publikuar vendimet. Kjo nënkupton se kjo gjykatë e kalon dukshëm kohën e paraparë në Ligjin për Gjykatat për publikimin e vendimeve. Në vitin e kaluar Gjykatës Themelore të Prishtinës i janë dashur 217 ditë kohë për t'i publikuar vendimet.

Gjyqtarët që kanë publikuar më së shumti vendime në Gjykatën Themelore në Prishtinë gjatë periudhës janar-dhjetor 2023 janë paraqitur në grafikonin në vijim.

FIGURA 27

Gjyqtarët me më së shumti vendime të publikuara në Gjykatën Themelore të Prishtinës gjatë periudhës janar-dhjetor 2023.



Pra, nga tabela e vendosur më sipër, shihet se gjyqtarët e Gjykatës Themelore të Prishtinës me më së shumti vendime të publikuara janë: Kreshnik Kaçiu (590 vendime të publikuara), nga Gjykatën Themelore në Prishtinë, Avdirrahman Gashi (287 vendime të publikuara) nga Dega në Lipjan, dhe Shefqet Baleci (174 vendime të publikuara) nga Dega në Glllogovc.



# Gjykata Themelore e Mitrovicës

Lëndët e zgjidhura




Vendime të publikuara




## FIGURA 28

Raporti ndërmjet lëndëve të zgjidhura dhe vendimeve të publikuara nga Gjykata Themelore e Mitrovicës gjatë periudhës janar-dhjetor 2023.



9,646



2,382

Gjykata Themelore e Mitrovicës, duke përfshirë katër degët e saj (*Skenderajin, Vushtrrinë, Leposaviqin dhe Zubin Potokun*) gjatë periudhës janar - dhjetor 2023 në ueb-faqe kanë publikuar gjithsej 2,382 vendime.<sup>13</sup>Ky nivel i publikimit ka shënuar rënje të theksuar në krahasim me vitin paraprak, kur kjo gjykatë kishte publikuar 3,254 vendime, përkatësisht -27%.<sup>14</sup>

Rrjedhimisht, në krahasim me numrin e lëndëve të zgjidhura nga Gjykata Themelore e Mitrovicës gjatë vitit 2023, numër ky që gjatë kësaj periudhe ishte 9,646 lëndë, rezulton se kjo gjykatë (përfshirë degët e saj) ka publikuar 25% të vendimeve nga lëndët e zgjidhura.

<sup>13</sup> Gjatë monitorimit të vendimeve në ueb-faqen e KGJK-së në këtë gjykatë janë evidentuar edhe 5 vendime të tjera të përsëritura, që nuk janë përfshirë në këto shifra.


<sup>14</sup> Kjo natyrisht ka ndodhur si pasojë e situatës së krijuar me mungesë të personelit administrativ dhe gjyqtarëve pas dorëheqjes së tyre në këtë gjykatë.

Për nga numri i vendimeve të publikuara (pa konsideruar lëndët e zgjidhura), Gjykata Themelore e Mitrovicës së bashku me degët është gjykata e dytë me më së paku vendime të publikuara për vitin 2023.

Publikimi i vendimeve nga Gjykata Themelore e Mitrovicës për secilin muaj, në mënyrë grafike është shfaqur në figurën e mëposhtme. Nga figura e mëposhtme shihet se numrin më të madh të aktygjyqimeve i ka publikuar në muajin shtator.

FIGURA 29

Niveli i publikimit të vendimeve nga Gjykata Themelore e Mitrovicës gjatë periudhës janar-dhjetor 2023.







Një pjesë të konsiderueshme të vendimeve të publikuara, janë publikuar nga degat e kësaj gjykate. Dega e Vushtrrisë ka publikuar 924 vendime nga 3,293 lëndë të zgjidhura (28 %), Dega e Skenderajt ka publikuar 563 vendime nga 1,445 lëndë të zgjidhura (39 %), Dega e Leposaviqit ka publikuar 7 vendime nga 107 lëndë të zgjidhura (7%), ndërsa Dega e Zubin Potokut 7 vendime nga 14 lëndë të zgjidhura (7%).

Publikimi i vendimeve nga degët e Gjykatës Themelore në Mitrovicë është shfaqur grafikisht në tabelën e mëposhtme.

**FIGURA 30**

Niveli i publikimit të vendimeve nga degët e Gjykatës Themelore të Mitrovicës gjatë periudhës janar-dhjetor 2023.

	 Skenderaj	 Vushtrri	 Leposaviq	 Zubin Potok
Janar	49	62	0	0
Shkurt	24	66	0	0
Mars	45	105	0	0
Prill	45	124	0	0
Maj	88	43	0	0
Qershor	53	140	0	0
Korrik	46	41	0	0
Gusht	51	43	0	0
Shtator	40	77	0	0
Tetor	39	65	0	0
Nëntor	59	50	0	0
Dhjetor	24	108	7	1

Pjesa më e madhe e vendimeve të publikuara janë të natyrës penale, përkatësisht 1,217 vendime penale, ndërsa 1,165 vendime janë të natyrës civile. Në grafikën në vijim është paraqitur lloji i vendimeve të publikuara nga Gjyakta Themelore e Mitrovicës gjatë periudhës janar-dhjetor 2023 sipas natyrës së veprës.



Nga vendimet penale, kjo gjykatë gjatë kësaj periudhë ka publikuar 15 vendime të korrupsionit dhe 22 vendime të dhunës në familje.


Ndryshe nga viti 2022, ku 827 vendime kanë qenë të publikuara në gjuhën serbe, gjatë periudhës janar-dhjetor 2023, asnjë vendim nuk është publikuar në gjuhën serbe.



Sa i përket anonimizimit të vendimeve, kjo gjykatë gjatë kësaj periudhe ka publikuar 114 vendime pa fshehjen e të dhënave personale.

Sa i përket zbatimit të Vendimit për Standardizimin e Formave të Vendimeve, nga të gjitha vendimet e publikuara nga kjo gjykatë dhe degët e saj, lëshime janë gjetur në 185 vendime. Ndërsa në pjesën tjetër prej 2,197 vendimesh, ky vendim është zbatuar me korrektësi.

Në tabelën e mëposhtme, në mënyrë grafike është shfaqur niveli i zbatimit të këtij vendimi nga Gjykata Themelore e Mitrovicës.



Nga monitorimi i publikimit të vendimeve të Gjykatës Themelore të Mitrovicës është vërejtur se kësaj gjykate i janë dashur mesatarisht 60 ditë për t'i publikuar vendimet. Kjo nënkupton se Gjykata Themelore e Mitrovicës sa i përket kohës së publikimit të vendimeve e respekton kohën e paraparë në Ligjin për Gjykatat për publikimin e tyre.

Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur gjyqtarët me më së shumti vendime të publikuara gjatë kësaj periudhe në Gjykatën Themelore të Mitrovicës.

FIGURA 34

Gjyqtarët që kanë publikuar më së shumti vendime në Gjykatën Themelore të Mitrovicës gjatë periudhës janar-dhjetor 2023.



Pra, nga tabela e vendosur më sipër, shihet se gjyqtarët e Gjykatës Themelore të Mitrovicës me më së shumti vendime të publikuara janë: Agron Maxhuni (248 vendime të publikuara), nga Dega në Vushtrri, Xhemajl Jusufi (215 vendime të publikuara), nga Gjykata Themelore e Mitrovicës, si dhe Avdullah Mecinaj (193 vendime të publikuara) nga Dega në Skenderaj.






# Gjykata Themelore e Pejës


Lëndët e zgjidhura



Vendime të publikuara



11,077



1,969



## FIGURA 35

Raporti ndërmjet lëndëve të zgjidhura dhe vendimeve të publikuara në Gjykatën Themelore të Pejës gjatë periudhës janar-dhjetor 2023.


Gjykata Themelore e Pejës, duke përfshirë tri degët e saj (Deçanin, Istogun dhe Klinën) gjatë periudhës janar-dhjetor 2023 ka publikuar 1,969 vendime<sup>15</sup>, përkatësisht 19% më shumë vendime se në vitin 2022 (1,661 vendime gjyqësore).

Me këto shifra, kjo gjykatë renditet e fundit sa i përket publikimit të vendimeve gjatë kësaj periudhe. Ndërkaq, në raport me numrin e lëndëve të zgjidhura, numër ky që gjatë vitit 2023 ishte 11,077 lëndë, rezulton se janë publikuar vetëm 18 % e vendimeve nga lëndët e zgjidhura.

<sup>15</sup> Gjatë monitorimit të vendimeve në ueb-faqen e KGJK-së në këtë gjykatë janë evidentuar edhe 8 vendime të tjera të përsëritura, që nuk janë përfshirë në këto shifra.


Pjesën më të madhe të vendimeve kjo gjykatë i ka publikuar gjatë muajit dhjetor, përkatësisht 488 vendime. Ndërsa më së paku vendime i ka publikuar në muajin shkurt, përkatësisht 40 vendime. Publikimi i vendimeve nga kjo gjykatë gjatë vitit 2023, të ndara në muaj, është pasqyruar në mënyrë grafike në tabelën e mëposhtme.

**FIGURA 36** Numri i vendimeve të publikuara në Gjykatën Themelore të Pejës gjatë periudhës janar-dhjetor 2023.



*Dega e Istogut* gjatë kësaj periudhe kishte publikuar 653 vendime, nga 1,857 lëndë të zgjidhura (35%), *Dega e Klinës* 326 vendime nga 1077 lëndë të zgjidhura (30%), ndërsa *Dega e Deqanit* 164 vendime nga 1486 lëndë të zgjidhura (11%). Niveli i publikimit të degëve të Gjykatës Themelore të Pejës për çdo muaj gjatë kësaj periudhe është paraqitur edhe në tabelën e mëposhtme.

**FIGURA 37** Niveli i publikimit të vendimeve nga degët e Gjykatës Themelore të Pejës gjatë periudhës janar-dhjetor 2023.




Nga numri i përgjithshëm i vendimeve të publikuara, 855 vendime janë të natyrës penale, ndërsa 1,114 sosh janë të natyrës civile. Natyra e vendimeve të publikuara nga kjo gjykatë është përshkruar edhe në grafikën e mëposhtme.



Nga të gjitha vendimet e publikuara, ne kemi evidentuar vetëm 8 vendime në lidhje me veprat penale të korrupsionit dhe asnjë vendim të dhunës në familje.

Kjo gjykatë nuk kishte publikuar asnjë aktgjykim në gjuhën serbe, njejtë sikurse në vitin paraprak. Kjo është paraqitur në mënyrë grafike edhe në tabelën e mëposhtme.




Gjatë monitorimit, nga numri i përgjithshëm i vendimeve të publikuara nga kjo gjykatë, ne kemi evidentuar 58 vendime të pa-anonizuara.

Zbatimi i Vendimit të KGJK-së për Standardizimin e Formave të Aktgjykimeve është arritur në shumicën e vendimeve të publikuara nga kjo gjykatë. Lëshime në zbatimin e këtij vendimi janë gjetur në 76 vendime të publikuara. Në tabelën e mëposhtme është shfaqur niveli i zbatimit të këtij vendimi nga kjo gjykatë gjatë kësaj periudhe.

**FIGURA 40**

Niveli i zbatimit të Vendimit për Standardizimin e Formave të Vendimeve në vendimet e publikuara nga Gjykata Themelore e Pejës.



Nga monitorimi i publikimit të vendimeve të Gjykatës Themelore të Pejës është vërejtur se kësaj gjykate i janë dashur mesatarisht 69 ditë për t'i publikuar vendimet. Kjo nënkupton se kjo gjykatë e ka kaluar afatin e paraparë në Ligjin për Gjykatat për publikimin e vendimeve.

Në tabelën e mëposhtme janë listuar gjyqtarët me më së shumti vendime të publikuara gjatë periudhës janar-dhjetor 2023 nga Gjykata Themelore e Pejës.

Pra, nga tabela e vendosur më sipër, shihet se gjyqtarët e Gjykatës Themelore të Pejës me më së shumti vendime të publikuara janë: Petrit Nrecaj (299 vendime të publikuara), nga Dega në Istog, Shemsedin Haxhijaj (296 vendime të publikuara), nga Dega në Istog, si dhe Genc Hoxha (170 vendime të publikuara) nga Gjykata Themelore e Pejës.

FIGURA 41

Gjyqtarët me më së shumti vendime të publikuara gjatë periudhës janar-dhjetor 2023 në Gjykatën Themelore të Pejës.






# Gjykata Themelore e Prizrenit

Lëndët e zgjidhura



Vendime të publikuara



12,679



4,618



## FIGURA 42

Raporti ndërmjet lëndëve të zgjidhura dhe vendimeve të publikuara në Gjykatën Themelore të Prizrenit gjatë periudhës janar-dhjetor 2023.

Gjykata Themelore e Prizrenit, duke përfshirë Degën e Suharekës dhe atë të Dragashit, gjatë periudhës janar-dhjetor 2023 ka publikuar gjithsej 4,618 vendime<sup>16</sup>, dhe renditet në vendin e pestë për nga numri i publikimit të vendimeve. Në krahasim me vitin paraprak, kur kjo gjykatë i kishte publikuar 3,011 vendime, ky nivel i publikimit të vendimeve gjyqësore këtë vit kishte shënuar rritje për 53%.

Gjatë vitit 2023 kjo gjykatë kishte zgjidhur gjithsej 12,679 lëndë, dhe rrjedhimisht nga të dhënat e monitorimit rezultoi se kjo gjykatë ka publikuar vetëm 18 % të vendimeve nga lëndët që gjatë kësaj periudhe kishin marrur epilog gjyqësor.


<sup>16</sup> Gjatë monitorimit të vendimeve në ueb-faqen e KGJK-së në këtë gjykatë janë evidentuar 6 vendime të përsëritura, që nuk janë përfshirë në këto shifra.

Pra, në krahasim me vitin paraprak kur kjo gjykatë kishte publikuar 3,011 vendime, në këtë vit ky numër ishte rritur për 53% më shumë.

Numrin më të madh të aktgjykimeve, kjo gjykatë i ka publikuar në muajin nëntor, ndërsa numrin më të vogël të aktgjykimeve në muajin prill. Në tabelën në vijim, në mënyrë grafike është pasqyruar shkalla e publikimit të vendimeve nga kjo gjykatë për çdo muaj të kësaj periudhe.

FIGURA 43

Niveli i publikimit të vendimeve të Gjykatës Themelore të Prizrenit gjatë periudhës janar-dhjetor 2023.





Dega e Suharekës kishte publikuar 437 vendime nga 2,129 lëndë të zgjidhura (21%), ndërsa Dega e Dragashit në ueb - faqe ka publikuar gjithsej 188 vendime nga 724 lëndë të zgjidhura (26 %).


Publikimi i vendimeve nga degët e Gjykatës Themelore të Prizrenit është shfaqur në mënyrë grafike për secilin muaj në tabelën e mëposhtme.



**FIGURA 44** Niveli i publikimit të vendimeve nga Degët e Gjykatës Themelore të Prizrenit gjatë periudhës janar-dhjetor 2023.


	 <b>Dragash</b>	 <b>Suharekë</b>
Janar	15	15
Shkurt	0	31
Mars	35	70
Prill	20	61
Maj	10	55
Qershor	5	16
Korrik	16	62
Gusht	13	11
Shtator	0	44
Tetor	31	31
Nëntor	38	30
Dhjetor	5	11

Sa i përket natyrës së vendimeve të publikuara, kjo gjykatë rënditet në vendin e tretë me publikimin e vendimeve penale, me 1,402 sosh, ndërsa civile 3,216 vendime. Klasifikimi i vendimeve sipas llojit të tyre është përshkruar edhe në tabelën e mëposhtme.



Nga aktgjykimet penale të publikuara, vetëm 3 prej tyre kanë të bëjnë me veprat penale të korrupsionit, ndërsa janë publikuar 8 aktgjykime të dhunës në familje.

Sa i përket gjuhës në të cilën janë publikuar vendimet, duhet të theksohet se gjatë kësaj periudhe nga 4,618 vendime të publikuara vetëm 8 vendime janë publikuar në gjuhën serbe (0.17%). Pra, të gjitha vendimet tjera të Gjykatës Themelore të Prizrenit kanë qenë vetëm në gjuhën shqipe.




Sa i përket mbrojtjes së të dhënave personale kjo gjykatë ka treguar kujdes të veçantë, ku nga numri i përgjithshëm i vendimeve, vetëm 27 prej tyre janë të pa anonimuzara.

Nga të gjitha vendimet e publikuara nga kjo gjykatë, lëshime në zbatimin e Vendimit të Këshillit Gjyqësor për Standardizimin e Formave të Aktgjykimeve janë vërejtur në 176 vendime. Ndërkaq në pjesën tjetër prej 4,442 vendimesh, shablloni është zbatuar në përpikmëri. Në grafikonin e mëposhtëm është përshkruar niveli i zbatimit të Vendimit për Standardizimin e Formave të Vendimeve në vendimet e Gjykatës Themelore të Prizrenit, për çdo muaj.

**FIGURA 47**

Niveli i zbatimit të Vendimit për Standardizimin e Formave të Vendimeve në vendimet e publikuara nga Gjykata Themelore e Prizrenit.



Nga monitorimi i publikimit të vendimeve të Gjykatës Themelore të Prizrenit është vërejtur se kësaj gjykate i janë dashur mesatarisht 52 ditë për t'i publikuar vendimet llogaritur nga dita e shpalljes, pra kjo gjykatë e ka respektuar afatin e paraparë me Ligjin për Gjykatat.

Gjyqtarët që kanë publikuar më së shumti vendime në Gjykatë Themelore të Prizrenit janë paraqitur në tabelën e mëposhtme.

FIGURA 48

Gjyqtarët me më së shumti vendime të publikuara në Gjykatën Themelore të Prizrenit gjatë periudhës janar-dhjetor 2023.



Pra, nga tabela e vendosur më sipër, shihet se gjyqtarët e Gjykatës Themelore të Prizrenit me më së shumti vendime të publikuara janë: Njomëza Berisha (405 vendime të publikuara), nga Dega në Dragash, Shyqri Hoxha (377 vendime të publikuara), nga Gjykata Themelore e Prizrenit, si dhe Taulant Rexhëbeqaj (357 vendime të publikuara) nga Gjykata Themelore e Prizrenit.




# Gjykata Themelore e Ferizajt


Lëndët e zgjidhura



Vendime të publikuara



6,282



3,005



## FIGURA 49

Raporti ndërmjet lëndëve të zgjidhura dhe vendimeve të publikuara në Gjykatën e Ferizajt gjatë periudhës janar-dhjetor 2023.

Gjykata Themelore e Ferizajt, duke përfshirë Degën e Kaçanikut dhe atë të Shtërpcës, gjatë periudhës janar – dhjetor 2023 ka publikuar 3,005 vendime.<sup>17</sup> Ky nivel i publikimit shënon rritje për 5% në krahasim me vitin paraprak, kur kjo gjykatë kishte publikuar 2,875 vendime gjyqësore.


Rrjedhimisht, prej 8,611 lëndëve të zgjidhura gjatë vitit 2023 nga kjo gjykatë, nga të dhënat e monitorimit rrjedh se gjatë këtij viti janë publikuar 35 % e vendimeve nga lëndët që këtë vit kishin marrur epilog gjyqësor.

Me këto shifra, kjo gjykatë renditet e pesta nga rradhët e gjykatave të shkallës së parë sa i përket publikimit të aktgjyqimeve në raport me lëndët e zgjidhura.

<sup>17</sup> Gjatë monitorimit të vendimeve në ueb-faqen e KGJK-së në këtë gjykatë janë evidentuar edhe 4 vendime të tjera të përsëritura dhe procesverbale, që nuk janë përfshirë në këto shifra.

FIGURA 50

Niveli i publikimit të vendimeve për çdo muaj nga Gjykata Themelore e Ferizajt gjatë periudhës janar-dhjetor 2023.



Në figurën e mëposhtme është shfaqur në mënyrë grafike publikimi i vendimeve për çdo muaj nga kjo gjykatë, gjatë periudhës janar-dhjetor 2023. Nga figura e mëposhtme, mund të shihet se numri më i madh i aktgjykimeve në këtë gjykatë është publikuar në muajin mars, ndërsa në muajin shtator janë publikuar më së paku aktgjykime.

Dega e Kaçanikut gjatë kësaj periudhe ka publikuar 648 vendime nga 1,210 lëndë të zgjidhura (54 %), ndërsa Dega e Shtërpcës ka publikuar 99 vendime nga gjithsej 401 lëndë të zgjidhura gjatë kësaj periudhe (25 %).

Në tabelën e mëposhtme në mënyrë grafike është shfaqur publikimi i vendimeve nga degët e Gjykatës Themelore të Ferizajt, për çdo muaj.

**FIGURA 51**

Publikimi i vendimeve nga degët e Gjykatës Themelore të Ferizajt gjatë periudhës janar-dhjetor 2023.

	 Kaçanik	 Shtërpçë
Janar	92	23
Shkurt	16	5
Mars	94	15
Prill	42	0
Maj	0	4
Qershor	55	10
Korrik	109	4
Gusht	41	3
Shtator	17	1
Tetor	63	21
Nëntor	66	4
Dhjetor	53	9

Gjykata Themelore e Ferizajt gjatë periudhës së monitorimit ka publikuar më shumë aktgjykime të natyrës civile, se sa penale. Nga numri i përgjithshëm i aktgjykimeve, 1,965 aktgjykime janë të natyrës civile, ndërsa 1,040 të natyrës penale.

Në tabelën e mëposhtme është shfaqur ndarja e vendimeve të publikuara gjatë kësaj periudhe nga Gjykata Themelore e Ferizajt, sipas llojit të tyre.



Nga të gjitha vendimet penale të publikuara nga kjo gjykatë, 8 prej tyre janë për veprat penale të korrupsionit, ndërsa për këtë vit kjo gjykatë nuk ka publikuar asnjë vendim të dhunës në familje. Ndërkaq, në vitin 2022 kjo gjykatë kishte publikuar 46 vendime të natyrës dhunë në familje.

Sa i përket gjuhës në të cilën janë publikuar këto vendime, kjo gjykatë gjatë periudhës janar-dhjetor 2023 ka publikuar 2,916 në gjuhën shqipe (97%) ndërsa 89 aktgjykimet tjera në gjuhën serbe (3%).






Gjatë kësaj periudhe të monitrit, Vendimi për Standardizimin e Formave të Vendimeve është zbatuar në 2,544 vendime apo 85% nga totali i përgjithshëm, ndërsa në pjesën tjetër prej 461 apo 15% vendimesh, është vërejtur lëshime në zbatimin e tij.

Në tabelën e mëposhtme mund të shihet zbatimi i Vendimit për Standardizimin e Formave të Vendimeve nga Gjykata Themelore e Ferizajt.

**FIGURA 54**

Niveli i zbatimit të Vendimit për Standardizimin e Formave të Vendimeve nga Gjykata Themelore e Ferizajt.



Gjatë periudhës janar-dhjetor 2023, Gjykata Themelore e Ferizajt ka publikuar 249 vendime pa fshehjen e të dhënave personale, numër i cili është rritur në krahasim me vitin e kaluar, ku vetëm 34 vendime ishin publikuar pa fshehjen e të dhënave personale.

Nga monitorimi i publikimit të vendimeve të Gjykatës Themelore të Ferizajt është vërejtur se kësaj gjykate i janë dashur mesatarisht 42 ditë për ti publikuar vendimet. Kjo nënkupton se kjo gjykatë vendimet i publikon brenda kohës së paraparë në Ligjin për Gjykatat për publikimin e tyre.

Në tabelën e mëposhtme janë renditur gjyqtarët me më së shumti vendime të publikuara gjatë periudhës janar-dhjetor 2023, nga Gjykata Themelore e Ferizajt.

FIGURA 55

Gjyqtarët me më së shumti vendime të publikuara nga Gjykata Themelore të Ferizajt gjatë periudhës janar-dhjetor 2023.



Pra, nga tabela e vendosur më sipër, shihet se gjyqtarët e Gjykatës Themelore të Ferizaj me më së shumti vendime të publikuara janë: Faton Ajvazi (865 vendime të publikuara) nga Gjykata Themelore e Ferizajt, Kreshnike Zymberi - Beqiri (175 vendime të publikuara) nga Gjykata Themelore e Ferizajt, si dhe Burhan Berisha (167 vendime të publikuara) nga Dega në Kaçanik.




# Gjykata Themelore e Gjilanit


Lëndët e zgjidhura



Vendime të publikuara



11,933



4,817



## FIGURA 56


Raporti ndërmjet lëndëve të zgjidhura dhe vendimeve të publikuara në Gjykatën Themelore të Gjilanit gjatë periudhës janar-dhjetor 2023.

*Gjykata Themelore e Gjilanit, duke përfshirë tri degët e saj (Degën e Kamenicës, Vitisë dhe të Novobërdës) gjatë kësaj periudhe ka publikuar gjithsej 4,817 vendime, përkatësisht 29% më shume se në vitin 2022. Ky nivel i publikimit të aktgjykimeve gjatë këtij viti, e rendit Gjykatën Themelore të Gjilanit në vendin e tretë për nga numri i publikimit të vendimeve gjyqësore.*

Rrjedhimisht, nga 11,933 lëndë të zgjidhura nga kjo gjykatë gjatë vitit 2023, rezulton se kjo gjykatë ka arritur të publikoj 40 % të vendimeve nga lëndët të cilat gjatë kësaj periudhe kishin marrur epilog gjyqësor.

Niveli i publikimit të vendimeve nga kjo gjykatë për secilin muaj, është paraqitur në mënyrë grafike në tabelën e mëposhtme. Nga kjo figurë shihet se pjesa më e madhe e aktgjykimeve është publikuar në muajin tetor, përkatësisht 516 aktgjykime gjatë atij muaji, ndërsa më së paku aktgjykime gjatë muajit shkurt, përkatësisht 321 aktgjykime.

**FIGURA 57** Niveli i publikimit të vendimeve nga Gjykata Themelore e Gjilanit gjatë periudhës janar-dhjetor 2023.



Një numër të madh të vendimeve të publikuara nga kjo gjykatë e kanë shtuar edhe degët e saj, ku të tri degët e gjykatës kanë publikuar 1,910 vendime gjyqësore apo 40% të vendimeve.

*Dega e Vitisë* gjatë kësaj periudhe ka publikuar 893 vendime nga 3,422 lëndë të zgjidhura (26%), *Dega e Kamenicës* ka publikuar 547 vendime nga 1,345 lëndë të zgjidhura gjatë kësaj periudhe (41%), ndërsa *Dega e Novobërdës* ka publikuar 470 vendime nga 642 lëndë të zgjidhura gjatë kësaj periudhe (73%). Kjo e fundit është dega me më së shumti lëndë të publikuara, në raport me lëndët e zgjidhura, gjatë kësaj periudhe.

Niveli i publikimit të vendimeve nga degët e kësaj gjykate për çdo muaj është shfaqur në mënyrë grafike në tabelën e mëposhtme. Nga të dhënat e pasqyruara në këtë figurë, shihet se numri më i madh i vendimeve nga degët është publikuar në muajin tetor.

**FIGURA 58** Niveli i publikimit të vendimeve nga degët e Gjykatës Themelore të Gjiçanit.



Pjesa më e madhe e vendimeve të publikuara nga kjo gjykatë, apo 3,537 vendime, janë të natyrës civile. Ndërsa pjesa tjetër prej 1,280 vendimesh janë të natyrës penale. Kjo ndarje e vendimeve të publikuara gjatë kësaj periudhe nga kjo gjykatë mund të shihet edhe në grafikën e mëposhtme.



Nga të gjitha lëndët e natyrës penale të publikuara në ueb-faqen e KGJK-së, FOL ka evidentuar 14 vendime të korrupsionit dhe 10 vendime të dhunës në familje.


Nga të gjitha vendimet e publikuara gjatë kësaj periudhe, 205 prej tyre janë të publikuara në gjuhën serbe (4%), ndërsa pjesa tjetër në gjuhën shqipe (96%).



Gjatë monitorimit, janë evidentuar 265 vendime të publikuara me mangësi të evidentuara në fshehjen e të dhënave personale. Ndërkaq sa i përket Vendimit për Standardizimin e Formave të Vendimeve nga kjo gjykatë, FOL ka evidentuar 344 vendime në të cilat ka pasur lëshime në zbatimin e këtij vendimi. Niveli i zbatimit të këtij vendimi në mënyrë grafike është paraqitur në tabelën e mëposhtme.

**FIGURA 61**

Niveli i zbatimit të Vendimit për Standardizimin e Formave të Vendimeve në vendimet e publikuara nga Gjykata Themelore e Gjilanit



Nga monitorimi i publikimit të vendimeve të Gjykatës Themelore të Gjilanit është vërejtur se kësaj gjykate i janë dashur mesatarisht 32 ditë për ti publikuar vendimet. Kjo nënkupton se kjo gjykatë e ka respektuar me përpikmëri kohën e paraparë me Ligjin për Gjykatat për publikimin e vendimeve.

Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur gjyqtarët me më së shumti vendime të publikuara nga Gjykata Themelore e Gjilanit, gjatë periudhës janar-dhjetor 2023.

FIGURA 62

Gjyqtarët me më së shumti vendime të publikuara në Gjykatën Themelore të Gjilanit gjatë periudhës janar-dhjetor 2023.



Pra, nga tabela e vendosur më sipër, shihet se gjyqtarët e Gjykatës Themelore të Gjilanit me më së shumti vendime të publikuara janë: Florije Qerimi (328 vendime të publikuara) nga Gjykata Themelore e Gjilanit, Alush Sinani (308 vendime të publikuara) nga Dega në Viti, dhe Mevlide Shabani (265 vendime të publikuara) nga Gjykata Themelore në Gjilan.






# Gjykata Themelore e Gjakovës


Lëndët e zgjidhura



Vendime të publikuara



8,045



4,857



## FIGURA 63

Raporti ndërmjet lëndëve të zgjidhura dhe vendimeve të publikuara në Gjykatën Themelore të Gjakovës gjatë periudhës janar-dhjetor 2023.

Gjykata Themelore e Gjakovës, duke përfshirë Degën e Rahovecit dhe atë të Malishevës, gjatë kësaj periudhe në ueb-faqen zyrtare ka publikuar gjithsej 4,857 vendime<sup>18</sup>, përkatësisht 47% më shumë se në vitin 2022. Me këtë shifër të publikimit, kjo gjykatë qendron e para në mesin e gjykatave të shkallës së parë (pas Gjykatës së Apelit) sa i përket nivelit të publikimit.

Ndërkaq, nga 8,045 lëndë të zgjidhura nga kjo gjykatë gjatë vitit 2023, nga të dhënat e monitorimit rezulton se kjo gjykatë ka arritur të publikoj rreth 60% të vendimeve nga lëndët e zgjidhura gjatë kësaj periudhe.


<sup>18</sup> Gjatë monitorimit të vendimeve në ueb-faqen e KGJK-së në këtë gjykatë janë evidentuar edhe 12 vendime të tjera të përsëritura, që nuk janë përfshirë në këto shifra.

Duke përfshirë raportin me lëndët e zgjidhura, kjo gjykatë është gjykata e dytë me më së shumti vendime gjyqësore të publikuara për vitin 2023 (pas Gjykatës Komerciale), ndërsa e para në mesin e gjykatave themelore.

Niveli i publikimit të vendimeve nga Gjykata Themelore e Gjakovës për secilin muaj të kësaj periudhe është shfaqur në mënyrë grafike në tabelën e mëposhtme.

FIGURA 64

Niveli i publikimit të vendimeve për çdo muaj nga Gjykata Themelore e Gjakovës, gjatë periudhës janar-dhjetor 2023.




Edhe degët e kësaj gjykate kanë kontribuar në mënyrë të konsiderueshme në rritjen e publikimit të vendimeve në kuadër të kësaj gjykate, duke publikuar gjithsej 2,014 vendime, apo 41% të të gjitha vendimeve të publikuara nga kjo gjykatë.

Gjatë kësaj periudhe, *Dega e Malishevës* ka publikuar 840 vendime nga 1,672 lëndë të zgjidhura (50%), ndërsa *Dega e Rahovecit* ka publikuar 1,174 vendime nga 2,170 lëndë të zgjidhura gjatë kësaj periudhe (54%). Kjo e fundit, llogaritet në kuadër të tri degëve me më së shumti lëndë të publikuara, në raport me lëndët e zgjidhura.


Në tabelën e mëposhtme në mënyrë grafike është pasqyruar publikimi i vendimeve të degëve të Gjykatës Themelore të Gjakovës gjatë kësaj periudhe.

**FIGURA 65** Niveli i publikimit të vendimeve nga Degët e Gjykatës Themelore të Gjakovës gjatë periudhës janar-dhjetor 2023.



Sa i përket llojit të vendimeve të publikuara, kjo gjykatë pas *Gjykatës së Apelit*, ka shënuar rekord në publikimin e llojit të lëndëve civile, ku 4,128 vendime janë publikuar të natyrës civile dhe vetëm 729 vendime janë publikuar të natyrës penale.

Kjo ndarje e vendimeve të publikuara nga Gjykata Themelore e Gjakovës është paraqitur edhe në grafikonin e mëposhtëm.



Nga vendimet penale, gjatë kësaj periudhe kjo gjykatë ka publikuar 6 aktgjykime në lidhje me veprat penale të korrupsionit dhe 22 aktgjykime në lidhje me veprat penale të dhunës në familje.

Gjykata Themelore e Gjakovës të gjitha vendimet i ka publikuar në gjuhën shqipe. Pra, nuk ka publikuar asnjë aktgjykim në gjuhën serbe.




Sa i përket anonimizimit të vendimeve nga kjo gjykatë, gjatë kësaj periudhe janë evidentuar 709 vendime të pa anonimizuara.<sup>19</sup>

Vendimi i Këshillit Gjyqësor të Kosovës për Standardizimin e Formave të Vendimeve nuk është zbatuar sa duhet nga kjo gjykatë. Lëshime në zbatimin e këtij vendimi janë evidentuar në 984 vendime të publikuara.<sup>20</sup>

**FIGURA 68**

Niveli i zbatimit të Vendimit për Standardizimin e Formave të Vendimeve në vendimet e publikuara nga Gjykata Themelore e Gjakovës.



Nga monitorimi i publikimit të vendimeve të Gjykatës Themelore të Gjakovës është vërejtur se kësaj gjykate i janë dashur mesatarisht 47 ditë për ti publikuar vendimet. Kjo nënkupton se edhe kjo gjykatë i ka publikuar aktgjykimet brenda afatit të paraparë me ligj.

Gjyqtarët me më së shumti vendime të publikuara në Gjykatën Themelore të Gjakovës janë paraqitur në grafikën e mëposhtme.

<sup>19</sup> Lëshime janë evidentuar në mos-fshehjen e emrave të palëve, emrat e bizneseve, adresat etj.

<sup>20</sup> Lëshime janë gjetur kryesisht në përdorimin e llogos së KGJK-së, në vend të Emblemsë së Republikës së Kosovës.

FIGURA 69

Gjyqtarët me më së shumti vendime të publikuara në Gjykatën Themelore të Gjakovës gjatë periudhës janar-dhjetor 2023.



Pra, nga tabela e vendosur më sipër, shihet se gjyqtarët e Gjykatës Themelore të Gjakovës me më së shumti vendime të publikuara janë: Durim Balaj (946 vendime të publikuara) nga Gjykata Themelore e Gjakovës, Mirjeta Shala (751 vendime të publikuara) nga Gjykata Themelore e Gjakovës, si dhe Betim Behluli (367 vendime të publikuara) nga Dega në Rahovec.

# Rekomandime

Bazuar në të gjeturat e këtij raporti të monitorimit, rekomandimet në vijim shihen si të domosdoshme për përmirësimin e ngecjeve të evidentuara në këtë fushë. Këto rekomandime janë:

- Këshilli Gjyqësor i Kosovës të hartoj sa më parë Udhëzimin e ri për publikimin e aktgjykimeve, të harmonizuar me Kodin e ri të Procedurës Penale.
- Të ngriten burimet njerëzore në gjykata dhe në degë, në mënyrë që të rritet numri i publikimit të aktgjykimeve.
- Të monitorohet nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës zbatimi i të gjitha rregulloreve dhe vendimeve të KGJK-së, duke përfshirë edhe Vendimin për Standardizimin e Formave të Aktgjykimeve.
- Të rritet publikimi i aktgjykimeve të keqpërdorimit të pozitës dhe autoritetit zyrtar.
- Të respektohet afati prej 60 ditësh për publikimin e aktgjykimeve llogaritur nga dita e shpalljes, i paraparë në Ligjin për Gjykatat.
- Të gjitha vendimet të publikohen në formatin PDF, siç kërkohet në Udhëzimin Administrativ për Publikimin e Aktgjykimeve të Përpunuara.

# Burimet:

- Kushtetuta e Republikës së Kosovës. Prill, 2008.
- Kuvendi i Republikës së Kosovës, Ligji (nr. 06/L-054) për Gjykatat, Dhjetor, 2018.
- Kuvendi i Republikës së Kosovës, Ligji (nr.04/L-032) për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Gjykatat.
- Kodi nr. 08/l-032 i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës.
- Këshilli Gjyqësor i Kosovës, Raporti Statistikor i Gjykatave Vjetori 2023.
- Këshilli Gjyqësor i Kosovës, Udhëzimi Administrativ (02/2016) për Anonimizimin dhe Publikimin e Vendimeve të Plotëfuqishme, Shkurt 2016.
- Këshilli Gjyqësor i Kosovës, Udhëzimi Administrativ (04/2019) për Publikimin e Vendimeve të Përpunuara, Dhjetor, 2019.
- Këshilli Gjyqësor i Kosovës, Shabllonet Standarde të Vendimeve – Vëllimi 1, 2018.
- Këshilli Gjyqësor i Kosovës, Raporti Statistikor i Gjykatave 2023.





# FOL

